




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT



# A po maturohet Matura Shtetërore?

RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023

QENDRESA  
QYTETARE



NED  
NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



AUTOR  
GEVIO TABAKU



## Tabela e përmbajtjes:

Çfarë është Matura Shtetërore?	3
Pse lindi nevoja për reformimin e maturës shtetërore?	4
Problematikat gjatë zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore	5
Matura Shtetërore 2020	6
Matura Shtetërore 2021	7
Matura Shtetërore 2022	8
Rekomandime:	10

**A po maturohet  
Matura Shtetërore?**

## Çfarë është Matura Shtetërore?

Matura Shtetërore u vendos si një ndryshim thelbësor në sistemin arsimor parauniversitar gjatë pranverës së vitit 2006<sup>1</sup>. Kjo reformë kishte për qëllim të eliminonte parregullsitë në administrimin dhe vlerësimin e provimeve të maturës në shkollat e mesme, si dhe të luftonte praktikat korruptive në regjistrimin e maturantëve në universitet.

Para se të zbatohet ky ndryshim, provimet e maturës ishin vetëm provime përmbyllëse të arsimit parauniversitar dhe regjistrimi në programe studimi në universitet bazohej në provimet hyrëse që organizonin vetë universitetet ose fakultetet. Administrimi dhe vlerësimi i provimeve të maturës ishin në përgjegjësi të stafit akademik të shkollave të mesme.

Në vijim të risive të vitit 2006 dhe para vitit shkollor 2018-2019, provimet e Maturës vinin në provë njohurisë dhe kompetencat e nxënësve në pesë provime; tre provime bazë dhe dy provime me zgjedhje<sup>2</sup>, por me ndryshimet e bëra gjatë vitit shkollor 2018-2019, nxënësit do duhet të zgjedhin vetëm një provim me zgjedhje.<sup>3</sup>

Gjuha shqipe dhe letërsia, së bashku me matematikën dhe gjuhën e huaj, formojnë provimet bazë të cilat kryhen nga të gjithë maturantët. Provimi i gjuhës së huaj ndryshon nga shkolla-në-shkollë në bazë të gjuhës kryesore që nxënësit zhvillojnë gjatë viteve të shkollës së mesme.

Provimet me zgjedhje zgjidhen nga vetë nxënësit dhe ndihmojnë në përcaktimin e profilit të tyre, bazuar në preferencat që kanë për regjistrimin në universitet. Çdo universitet përcakton kriteret e veta dhe u jep aplikantëve më shumë pikë në rast se ata kanë zgjedhur një provim me zgjedhje të caktuar. Provimet me zgjedhje përfshijnë:

- Biologji
- Ekonomi
- Filozofi-Sociologji
- Fizikë
- Gjeografi
- Histori
- Kimi
- Qytetari-Psikologji
- Histori Baletit
- Histori Muzike
- Histori Arti

<sup>1</sup> <https://qbz.gov.al/share/kM3RCV0lQie6ts6FBvMhOg>

<sup>2</sup> [https://qbz.gov.al/share/HXdU9mIQS6W-SA2N\\_F77kg](https://qbz.gov.al/share/HXdU9mIQS6W-SA2N_F77kg)

<sup>3</sup> <https://qbz.gov.al/share/yHNvfrJLQcKbRNuKfqICwA>



Maturantët mund të zgjedhin vetëm një provim me zgjedhje. Zgjedhja e provimit me zgjedhje bëhet nëpërmjet plotësimit të formularit A1, gjatë vitit të fundit të shkollës së mesme.

Rezultatet e nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore luajnë një rol të rëndësishëm në kualifikimin e tyre universtar, pasi në shumicën e rasteve, ato përbëjnë 50% të pikëve totale të kualifikimit që përcaktohen nga kriteret e pranimit të universiteteve. Kjo do të thotë se suksesi i një nxënësi në këto provime është thelbësor për të siguruar një vend në universitet.

## Pse lindi nevoja për reformimin e maturës shtetërore?

Reforma e Maturës Shtetërore në vitin 2006 ishte një hap i rëndësishëm për të adresuar sfidat dhe problematikat e sistemit arsimor në Shqipëri. Referuar një studimi të kryer nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA)<sup>4</sup>, reforma synonte të arrinte pikat e mëposhtme:

1. Standardizimi i provimeve: Një ndër qëllimet kryesore të reformës ishte standardizimi i provimeve të maturës për të gjithë maturantët, pavarësisht nga lloji i shkollës së mesme që kishin ndjekur. Kjo do të garantonte një vlerësim të drejtë dhe objektiv të njohurive të tyre.
2. Transparencë dhe ndershmëri: Duke iu dhënë fund praktikave korruptive në pranimin në universitet, reforma synonte të rriste besueshmërinë dhe ndershmërinë e sistemit të arsimit të lartë. Kjo u arrit përmes ndarjes së rolit të maturës dhe provimeve të pranimit në universitet, ku rezultati i maturës u bë kriteri kryesor për pranimin në universitet.
3. Fuqizimi i lidhjeve midis arsimit të mesëm dhe të lartë: Reforma e Maturës Shtetërore kishte si objektiv forcimin e lidhjeve midis arsimit të mesëm dhe të lartë, duke synuar garantimin e një kalimi më të qetë për maturantët.
4. Integrimi me sistemet arsimore të BE: Reforma e Maturës Shtetërore u synua të ndihmonte Shqipërinë në procesin e integritit të sistemit të saj arsimor me sistemet arsimore të Bashkimit Evropian. Kjo do të mundësonte një harmonizim të standardeve dhe praktikave arsimore me ato të vendeve anëtare të BE-së.

Ndërkaq, me reformimin e Maturës Shtetërore, synohej të arrihej drejtësi dhe barazi për të gjithë studentët, Provimet e Maturës të konsiderohen si pjesë e një procesi arsimor dhe indikatorë të cilësisë së arsimit dhe ky sistem të shërbejë si urë lidhëse midis arsimit para-universitar, atij universitar, dhe tregut të punës.

<sup>4</sup> <https://www.idrainstitute.org/files/reports/State%20Matura/Matura%20Shteterore%202012.pdf>



## Problematikat gjatë zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore

Procesi i provimeve të Maturës Shtetërore ka sjellë shqetësime të ndryshme për maturantët ndër vite, duke ngritur problematika të cilat lidhen me hartimin, vlerësimin dhe organizimin e tyre. Që nga viti 2020, të paktën një nga provimet e Maturës Shtetërore është pasuar me reagim nga maturantët, ku në shumicën e rasteve është kërkuar përsëritje e provimeve, ose ndryshime në skemën pikë-notë.

Gjatë protestave të ndërmarra, maturantët kanë theksuar si shqetësim kryesor hartimin e pyetjeve, të cilat sipas tyre dalin jashtë programeve orientuese<sup>5</sup> të secilës lëndë.

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit, gjatë analizës dhe publikimit të raportit për Maturën Shtetërore në vitet 2015-2022, ka zbuluar se ekziston një fiktivitet në rezultatet e viteve të shkollës së mesme, të cilat janë të ndryshme nga rezultatet që maturantët arrijnë në provimet e maturës. Në disa raste, ndryshimi midis notës mesatare vjetore dhe notës së fituar gjatë provimeve të maturës kap një diferencë deri në 5 nota.

Një ndër arsyt që e shkaktojnë këtë diferencë të ndjeshme, është mënyra e administrimit të provimeve të maturës. Gjatë periudhës 2006 - 2022 provimet janë mbajtur në klasa të dedikuara të shkollave të ndryshme për secilin qytet. Nxënësit akomodoheshin në këto klasa, duke respektuar parimin një-nxënës-për-bankë dhe duke mbajtur një distancë fizike të përcaktuar, prej 1 metër e 30 cm. Mësues të ndryshëm nga secila shkollë, përzgjidheshin përmes një shorti të administruar nga Drejtoritë Arsimore (sot Zyrat Arsimore) të qarqeve përkatëse dhe mbikëqyrnin zhvillimin e provimit në klasat respektive, duke u kujdesur edhe për të siguruar zbatimin e rregullave nga nxënësit.

Megjithatë, të gjithë këta faktorë nuk ia kanë dalë ndër vite të shmangin komunikimin mes nxënësve dhe për pasojë, kopjimin. Arsyet për këtë përfshijnë faktin se mësuesit mbikëqyrnin nxënës të qyteteve të tyre, me të cilët njiheshin paraprakisht nga rrethi familjar apo shoqëror. Në këto kushte, ka qenë e vështirë ruajtja e formalitetit. Një arsye potenciale është se mësuesit-administratorë, fillimisht janë paguar për orët gjatë të cilave do të ushtronin rolin ekstra-kurrikular si vëzhgues, por shumë shpejt pagesa për ta u hoq, duke zhbërë kështu edhe një nga motivimet e tyre për t'u treguar korrektë gjatë procesit (edhe pse provimet ndodhnin gjatë javëve mësimore, përgjegjësia që vinte me to nuk ishte e krahasueshme me një orë mësimi). Së fundmi, vit pas viti teza e provimeve të maturës ka qarkulluar para provimit, duke mundësuar kopjimin në masë.

Në përmbyllje, fenomeni i gjetjes së diferencës së ndjeshme mes mesatares së gjimnazit dhe notës së provimit të maturës, shoqërohet me pasoja negative për kualifikimin e mëtejshëm të maturantëve në universitet, çka sjell

<sup>5</sup> Programet orientuese kanë si qëllim të orientojnë punën e mësuesve, përgatitjen e nxënësve dhe hartuesve të testeve përfundimtare për provimet e Maturës Shtetërore. (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar)



minim të meritokracisë sidomos në programe studimi ku konkurrenca është e lartë.

## Matura Shtetërore 2020

Provimet e Maturës Shtetërore të vitit 2020 u zhvilluan gjatë pandemisë së Covid-19, çka bëri që formati i mbajtjes së tyre të paraqiste ndryshime të rëndësishme, krahasuar me vitet e kaluara. Në provimet e maturës që zhvillohen në kushte normale, rreth 60% e pyetjeve janë me alternativa dhe pjesa tjetër me shtjellim. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe të veçantë, të gjitha pyetjet u ndryshuan dhe u bënë me alternativa, për të siguruar një proces më të thjeshtë testimi.

Kjo nënkupton se provimi i letërsisë, i cili më parë përfshinte disa seksione shtjelluese, të cilat synonin të masnin aftësitë shkruese të nxënësve, u reduktua në një test me alternativa. Provimi nuk përfshinte shkrimin e një eseje apo të një krijimi të lirë, por përmbante 60 pyetje objektive, të gjitha me zgjedhje të shumëfishtë. Koha për zgjidhjen e testit ishte dy orë, rrjedhimisht nxënësit do të kishin 2 minuta kohë për të përzgjedhur alternativën e saktë të secilës pyetje.

Programet orientuese gjithashtu pësuan ndryshime nga ana e ASCAP<sup>6</sup>, me qëllim minimizimin e temave mësimore që përkonin me periudhën mars-qershor. Kjo ishte koha kur mësimi në të gjitha nivelet e arsimit u zhvillua në distancë, për shkak të kushteve që diktonte pandemia Covid-19. Më 8 maj 2020, QSHA konfirmoi një ndër rritje kryesore të maturës, korrigjimin elektronik të testeve (njofftimi paraprak ishte kryer që në shkurt 2020), duke shmangur vonesat dhe gabimet njerëzore gjatë procesit.

Njofftimi për këtë ndryshim erdhi pak para zhvillimit të provimit dhe si rrjedhojë, procesi i testimit së bashku me rezultatet e tij hasën qëndresë nga ana e nxënësve. Problematikat e shprehura nga ana e nxënësve lidheshin kryesisht me i) moskuptimin e pyetjeve nga ana e tyre, pasi ato paraqisnin realitete fiktive dhe të pahasura nga ta gjatë procesit të mësimi apo përditshmërisë, ii) kohën e pamjaftueshme për të zgjidhur testin, pasi 2 minuta në dispozicion nuk mjaftonin për të lexuar, kuptuar dhe kthyer përgjigje ndaj pyetjeve, të cilat së bashku me përgjigjet ishin shumë të gjata, iii) pamundësinë për të kthyer përgjigje të argumentuara, ndaj pyetjeve që gjerësisht u perceptuan si subjektive.

Kufizimet që solli pandemia e ndikuan tërësisht zhvillimin e procesit mësimor, por si një ndër veprimtaritë e para që u mbajtën pak pas shpalljes së karantinimit, matura shtetërore 2020 u përball me sfida të shumta dhe mori përmasë mediatike për shkak të pakënaqësisë së shprehur nga ana e maurantëve.

Megjithatë, pati edhe mësues mes atyre që kundërshtuan përmbajtjen e testit. Motivet e tyre lidheshin kryesisht me aspekte teknike të provimit, të tilla si i) kërkesat e pyetjeve ishin të gjata dhe jo-konçize, ndonjëherë edhe të

<sup>6</sup> Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar



formuluara ndryshe nga rregullat e gjuhësisë shqipe, ii) nxënësit, kryesisht të qyteteve të vogla, kishin shumë mundësi për të kopjuar, falë formatit të testimit dhe njoftimit të vonë se provimet do të zhvilloheshin, pa procedura të qarta në procesin e vlerësimit dhe identifikimit të mundësisë për kopjim dhe iii) të gjitha pyetjet vlerësoheshin me pikë të barabarta, pa mundësuar që nivele të ndryshme të taksonomisë të vlerësohen me pikë të ndryshme.

## Matura Shtetërore 2021

Gjatë vitit akademik 2019 - 2020 mësimi u realizua online duke filluar nga muaji mars, kur Shqipëria u vendos edhe në karantinë të detyrueshme. Ndërsa viti akademik 2020 - 2021 (shtator 2020 - qershor 2021), në shumë shkolla, u realizua plotësisht online për të gjitha nivelet e studimit. Kjo metodë u gjykua e nevojshme dhe e pashmangshme, në kushtet e diktuar nga pandemia Covid-19, megjithatë procesi dhe përvoja e mësimdhënies, e po ashtu ecuria e provimeve të maturës, u shoqëruan me një sërë pasojash.

Nëntori i vitit 2020 filloi me një tjetër protestë studentësh universitarë, këtë herë të motivuar nga problematikat që sipas tyre shoqëronin procesin e mësimi online. Ndër këto problematika theksohej edhe mungesa e efektivitetit të mësimi online, sidomos nga studentët e vitit të parë bachelor, të cilët risillnin si faktor përvojën e keqe me provimet e maturës shtetërore, pas tre muajve mësim online që i parapriu ato në gjimnaz.<sup>7</sup>

Provimet e Maturës Shtetërore 2021 u mbajtën në rreth 208 qendra të dedikuara, duke respektuar masat anti-Covid19, çka nënkupton se një klasë mund të akomodonte maksimalisht 15 nxënës. Në ndryshim nga viti i shkuar, tezat përmbanin si pyetje me alternativa, ashtu edhe me shtjellim, ndërsa koha në dispozicion të nxënësve për zgjidhjen e tezës ishte 2 orë e 30 minuta. Këtë vit, në fjalët e Ministres Kushi, synohej garantimi i meritokracisë dhe dallimi i më të mirëve. Për këtë synim, shkalla e vështirësisë së provimit do të ulët dhe artikulimi i tezave do të jetë i kujdesshëm, për të reflektuar ndjeshmëritë e shkaktuara nga mësimi online.<sup>8</sup>

Megjithatë, procesi edhe kësaj radhe hasi qëndresën e maturantëve, pikërisht lidhur me kohën e pamjaftueshme për të zgjidhur tezen dhe pyetjet komplekse e të ngatëruara, veçse këtë herë ishte provimi i Matematikës ai që mbarti problematika. Nxënësit pretenduan që provimi i kalonte pritshmërinë mbi vështirësinë dhe nuk i përmbahej tezave model që kishin realizuar.

Nxënësit pretenduan se edhe provimi i gjuhës së huaj Anglisht i tejkalonte pritshmëritë, pasi testonte nivelin C1, çka nuk ishte aplikuar asnjëherë më parë (provimi duhet të ketë nivelin B2).

Peizazhi që la pas Matura Shtetërore 2021 ishte i paqëndrueshëm, deri diku kaotik dhe i paqartë për nxënësit dhe prindërit e tyre, një formulë që

<sup>7</sup> <https://citizens-channel.com/2020/11/02/jo-mesimit-online-studentet-protjestojne-para-ministrise-se-arsimit/>

<sup>8</sup> <https://www.portalishkollor.al/news/matura-shteterore-2021-ministrja-kushi-bashkebesedim-me-maturantet-per-procesin-e-organizimit>



parasheh se në të ardhmen do të ketë përsëri ndryshime për të adresuar problematikat.

## Matura Shtetërore 2022

Viti akademik 2021 - 2022 i priti nxënësit me opsionin e mësimit të kombinuar, i cili zhvillohej pjesërisht online dhe pjesërisht nëpër klasa. Specifikisht për maurantët, klasat kanë qenë gjithmonë të hapura dhe të gatshme për mësim fizik, në mënyrë që të shmangeshin disa nga problematikat e hasura gjatë mësimit online në vitin e shkuar akademik.

Në marsin e vitit 2022, gjatë interpelancës për Maturën Shtetërore në Parlament, Ministria e Arsimit dhe Sportit prezantoi analizën e kryer në nivel kombëtar të Maturës Shtetërore 2021 dhe paraqiti dhe masat e planifikuara nga qeveria për Maturën Shtetërore 2022.<sup>9</sup>

Ndër ndryshimet e radhës përfshihej mbikëqyrja e procesit të vlerësimit të testeve nga grupet e punës së ngritura nga MAS, e gjithashtu hartimi i testeve të Gjuhë-Letërsisë e Matematikës duke ndjekur disa hallka kontrolli dhe me mbikëqyrjen e MAS. Ndërsa kohëzgjatja e provimit mbetej 2 orë e 30 minuta, pyetjet e kombinuara mes alternativave dhe shtjellimit dhe pikësimi maksimal 60 pikë. Tezat ishin hartuar në mënyrë që 40% e tyre të ishin të nivelit të parë, 40% të nivelit të dytë dhe 20% e pyetjeve të bënin diferencën mes nxënësve.

Këto ndryshime adresonin disa nga shqetësimet e ngritura gjatë seancave të shkuara të Maturës Shtetërore, përkatësisht nevojën për vlerësim të drejtë dhe cilësor, të realizuar brenda një kohe të shkurtër (brenda datës 5 korrik, në mbështetje të maurantëve që synonin studimet jashtë vendit dhe brenda datës 15 korrik për të gjithë maurantët e tjerë). Së dyti, ndryshimet adresonin shqetësimet e nxënësve se provimet përmbanin pyetje të pakuptimta dhe që nuk rridhnin nga thelbi i programit të tyre.<sup>10</sup>

Këto ndryshime ishin të vogla dhe nuk përbënin ndonjë devijim të ndjeshëm nga procesi i deriatëhershëm i zhvillimit të Maturës Shtetërore. Megjithatë, zhvillimi i provimeve dëshmoi se problematikat lidhur me keqadministrimin e procesit dhe kopjimin masiv mbeteshin, pasi tezat e Matematikës dhe Gjuhës Shqipe e Letërsisë qarkulluan në rrjet pak pas fillimit të provimeve.

Gjithashtu, nuk ishte zhdukur plotësisht problematika e artikulimit të pyetjeve dhe kërkesave përtej programit orientues, kësaj radhe e evidentuar nga nxënësit që u testuan për njohuritë në lëndën me zgjedhje Biologji.

<sup>9</sup> <https://top-channel.tv/2022/03/10/kushi-kujton-problemet-e-matures-2021-dhe-njofton-ndryshimet-per-kete-vit-hartimi-i-testit-ne-kushte-te-larta-sigurie-ekipe-nga-ministria-do-kontrollojne-procesin/>

<sup>10</sup> <http://www.panorama.com.al/1130119-2/>





## Përse lindi nevoja për reformimin e maturës shtetërore në vitin 2023?

Pas tre viteve që matura shtetërore u prit me shprehje pakënaqësie në forma të ndryshme nga maturanët, MAS njoftoi disa ndryshime rrënjësore për Maturën Shtetërore të vitit 2023.

Një grup pune u ngrit për të analizuar aktet ligjore e nënligjore për zhvillimin e Maturës Shtetërore, si dhe rregulloren e procedurat e mbajtjes së saj. Gjetjet e këtij grupi kanë diktuar nevojën për ndryshim.

Ndryshimi kryesor është që Matura Shtetërore 2023 do të pilotojë një testim elektronik të vëzhguar, të organizuar nga QSHA në të njëjtin format që mbahen provimet e licencave, për të gjithë kandidatët që synojnë të regjistrohen në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme. Pësha e këtij provimi do të jetë 30%, ndërsa 70% do të përbëhet nga notat e gjimnazit dhe provimeve të maturës.

Ambientet ku do të mbahen provimet e maturës do të jenë të mëdha, për të akomoduar së paku 150 maturanë dhe masat e sigurisë të larta, duke përfshirë edhe monitorim në kohë reale me kamera. Megjithatë ndryshime të kësaj forme në procesin e provimeve të maturës janë bërë edhe më parë, ato nuk kanë sjellë rezultate të prekshme. Për shembull, një masë e aplikuar që nga Matura Shtetërore e vitit 2018 është vendosja e maturanëve në palestrat e shkollave të mesme ku zhvillohen provimet, me qëllim të sigurimit të një ambienti të kontrolluar. Megjithatë, kjo nuk ka arritur të ketë një efektshmëri të konsiderueshme, pasi tezat e provimeve nga brenda këtyre ambienteve janë përhapur në rrjete sociale vetëm pak minuta pas nisjes së provimeve.

Ndryshimi tjetër do të preki fondin e pyetjeve dhe hartimin e testit përfundimtar, në mënyrë që të shmangen problemet e përsëritura me pyetje që shkojnë përtej programit orientues apo nivelit të vështirësisë. Maturanët me aftësi ndryshe do të testohen tashmë në provime të veçanta, me nivel më të lehtë vështirësie.

Së fundmi, një ndryshim i ndjeshëm që nga viti 2006 kur u prezantua Matura Shtetërore, është krijimi i procedurës së ankimimit apo rivlerësimi të tezave. Paçka se ky është një ndryshim i rëndësishëm dhe ka qënë ndër kërkesat më të shpeshta të maturanëve ndër vite, për të siguruar që procesi të jetë efikas dhe pa abuzime, është e nevojshme që ai të bëhet sa më transparent dhe i kontrolluar.

**A po matorohet  
Matura Shtetërore?**



# A po matorohet Matura Shtetërore?

## Rekomandime:

- Të rikthehen pagesat për mësuesit të cilët angazhohen si administratorë gjatë zhvillimit të provimeve të maturës në mënyrë që të shërbejë si incentivë për të mirë-administruar procesin.
- Të ndiqet me rigorozitet të plotë rregullorja e Maturës Shtetërore bashkë me të gjitha udhëzimet e tjera për të minimizuar kopjimin në masë dhe si rrjedhojë komprometimin e procesit dhe minimin e meritokracisë.
- Të përditësohet metodologjia e zhvillimit të procesit të Maturës Shtetërore dhe të ndërmerren politika konkrete të cilat mundësojnë uljen e hendekut të mesatares së shkollës së mesme kundrejt mesatares së provimeve të maturës.
- Të zhvillohen fushata informimi për të informuar maurantët që do të ndjekin programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme" rreth provimit të informatizuar që ata do të zhvillojnë si edhe rreth zhvillimit të provimeve në salla të mëdha së bashku me procedurat respektive të sigurisë.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NED

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)